RAPORTI I PERFORMANCËS 2025



BASHKIA PRRENJAS

Dokumenti bazohet në të dhënat e Sistemit të Matjes së performancës 2024.Ky dokument është prodhuar nga Bashkia Prrenjas me asistencën e Projektit Bashki të Forta.

PËRMBAJTJA

Fjalor Shpjegues 3

Qellimi I Raportit 7

Vështrim i Përgjithshëm mbi Bashkinë 7

Të Dhënat e Përgjithshme të Bashkisë 9

SHERBIME PUBLIKE VENDORE 10

Arsimi Paraniversitar 11

Menaxhimi i Mbetjeve 13

Mbrojtja nga zjarri 16

Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit 19

Administrimi i pyjeve dhe kullotave 21

Mbrojtja Sociale 24

QEVERISJA E MIRE 27

Burimet Njerëzore 27

Transparenca 29

Barazia Gjinore 31

EU Integrimi në BE 35

MENAXHIMI FINANCIAR 37

Përfundime dhe Rekomandime 42

FJALOR SHPJEGUES

Disagregim

Është procesi i ndarjes së të dhënave sipas kategorive të veçanta (si gjinia, mosha, vendbanimi urban/rural, tipi i institucionit publik/privat etj.) me qëllim që të kuptohet më mirë shpërndarja dhe ndikimi i një shërbimi ose fenomeni. Disagregimi ndihmon për të evidentuar pabarazitë, për të krahasuar grupet e ndryshme dhe për të planifikuar politika apo ndërhyrje më të drejtuara dhe gjithëpërfshirëse.

Funksion

Është fusha e veprimtarisë, për të cilën njësia e vetëqeverisjes vendore është përgjegjëse dhe ka kompetencën ligjore për ta ushtruar lirisht, tërësisht apo në një pjesë të tij, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore

Nën-Tregues

Një nën-tregues është një element më i detajuar i një treguesi kryesor, që shërben për ta shpërbërë dhe matur më saktësisht një aspekt të veçantë të tij. Nën-treguesit ndihmojnë në kuptimin më të thelluar të performancës, duke dhënë informacion të ndarë sipas gjinive, zonave gjeografike, llojit të shërbimit (publik/privat) apo kritereve të tjera të disagregimit.

Produkt

Një produkt i realizuar nga bashkia i referohet një të mire materiale ose shërbimi që ofrohet nga bashkia, e cila është përgjegjëse për ofrimin e shërbimit apo të mirës materiale. Bashkitë sipas ligjit janë përgjegjëse për ofrimin e një game të gjerë shërbimesh publike, si transporti, kanalizimi, furnizimi me ujë, menaxhimi i mbetjeve, shërbimet e mbrojtjes nga zjarri dhe asaj civile etj.

Qeverisja e Mirë

I referohet parimeve dhe praktikave që garantojnë funksionimin efikas, transparent, gjithëpërfshirës dhe të drejtë të një bashkie. Në këtë kuadër përfshihen elementë si transparenca publike, barazia gjinore, integrimi në BE, pjesëmarrja qytetare, profesionalizmi i burimeve njerëzore dhe menaxhimi i qëndrueshëm financiar.

Sistemi i Matjes së Performancës

Është mekanizmi kombëtar dhe vendor për mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave mbi ofrimin e shërbimeve nga bashkitë. Ky sistem përfshin një grup treguesish dhe nën-treguesish të standardizuar, që përdoren për të krahasuar performancën e bashkive, për të rritur transparencën, llogaridhënien dhe për të mbështetur vendimmarrjen e bazuar në evidencë.

Bazuar në Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 33, çdo bashki është e detyruar të krijojë një sistem të brendshëm matjeje dhe raportimi mbi performancën e saj, në lidhje me ofrimin e shërbimeve publike, përdorimin e burimeve dhe realizimin e objektivave. Ky sistem vendor lidhet ngushtë me sistemin kombëtar, duke mundësuar harmonizimin e të dhënave dhe krahasimin mes njësive të vetëqeverisjes vendore.

Sherbime Publike Vendore

Janë shërbimet që ofrohen nga bashkia për komunitetin, në përputhje me funksionet e përcaktuara nga ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore". Këto përfshijnë, ndër të tjera, , ndriçimin publik, arsimin parashkollor dhe çerdhet, mbrojtjen sociale, menaxhimin e mbetjeve, pyjeve e kullotave dhe ujitjen dhe kullimin etj. Sipas përkufizimit the ligjit "janë ato shërbime me interes të përgjithshëm publik, të cilat ofrohen për komunitetin nga bashkitë, në mënyrë të vazhdueshme, me çmime të përballueshme, sipas standardeve minimale kombëtare, të përcaktuara me ligj apo me akte të tjera normative'

Tregues performance

Një tregues i performancës është një matje që përdoret për të vlerësuar suksesin ose përparimin e një procesi. Mund të përdoret për të gjurmuar arritjet kryesore të performancës, të tilla si performanca financiare, kënaqësia e klientit, produktiviteti i punonjësve ose efikasiteti operacional, ose buxhetor / financiar dhe për të përcaktuar nëse synimet ose objektivat po përmbushen. Treguesit e performancës përdoren shpesh në sektorin privat por edhe ate publik dhe organizata të tjera për të ndihmuar menaxherët të marrin vendime të informuara, të identifikojnë fushat e përmirësimit dhe të masin performancën e përgjithshme të bashkisë.

Të Dhëna

Janë informacionet e mbledhura nga burime zyrtare të bashkisë ose institucione të tjera, që shërbejnë si bazë për llogaritjen e treguesve të performancës. Të dhënat mund të jenë numerike (statistika mbi popullsinë, buxhetin, shkollat etj.) ose cilësore (planifikime, raporte, dokumente strategjike) dhe janë të domosdoshme për analizën dhe raportimin e performancës.

Taksat e ndara

Janë taksa kombëtare që mblidhen nga qeveria qendrore dhe ndahen plotësisht ose pjesërisht me bashkitë

Taksat vendore

Janë detyrime fiskale të bashkisë të cilat paguhet sipas parashikimeve ligjore dhe përcaktimeve të Këshillit Bashkiak

Tarifat vendore

Janë detyrime që individët apo bizneset paguajnë kundrejt marrjes së një shërbimi të ofruar nga bashkia

Transfertat e kushtëzuara

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur vetëm për projekte të veçanta apo funksione të deleguara të bashkisë

Transfertat e pakushtëzuara

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur pa kushte, pa interes dhe pa të drejtë kthimi

Transferta e pakushtëzuar sektoriale

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë me kushtin për t'u përdorur vetëm për funksione specifike që bashkia i ka marrë nga Qeveria me ligj të veçantë

Trashëgimi nga viti i kaluar

Janë fonde buxhetore të bashkisë të cilat nuk janë shpenzuar në mbyllje të vitit buxhetor të kaluar dhe mund të përdoren në vitin korent buxhetor. Ato mund të jenë me destinacion dhe pa destinacion. Varësisht nga kjo ato mund të përdoren gjatë vitit korent me destinacion të përcaktuar (për ato projekte apo zëra buxhetor specifik për të cilat janë angazhuar gjatë vitit të kaluar por nuk kanë arritur të shpenzohen) apo pa destinacion (për çfarëdo zë apo projekt).

Si të lexojmë tabelën e performancës

Tabelat e treguesve ne cdo fushe paraqesin ecurinë e treguesve të performancës për secilën fushë funksionale. Për çdo tregues jepen vlerat për dy vite, ndryshimi ndërvite, trendi, dhe semafori, të cilat ndihmojnë në interpretimin e rezultateve.

Kolona	Përshkrimi
Treguesi	Emri i treguesit që mat një aspekt të caktuar të performancës (p.sh. "Përqindja e konsultimeve publike të zhvilluara").
Njësia matëse	Tregon mënyrën se si matet treguesi (p.sh. %, numër, ha, lekë/frymë).
Vlera 2023 / 2024	Tregojnë rezultatet e arritura për secilin vit.
Ndryshimi (%)	Diferenca në përqindje ndërmjet viteve. Formula: (Vlera 2024 − Vlera 2023) / Vlera 2023 × 100.
Trendi dhe Simboli i Trendit (→ ↑ ↓)	Diferenca në vlerë absolute ndërmjet viteve. (Vlera 2024 − Vlera 2023). Simboli I Trendit tregon drejtimin e lëvizjes: ↑ përmirësim, ↓ përkeqësim, → stabilitet
Semafori	Vlerësim vizual i nivelit të performancës: □ = vlere absolute ndryshimi positiv ● =vlere absolute ndryshimi negative.

Nota metodologjike mbi semaforin dhe interpretimin e treguesve

Në tabelat e performancës, ngjyra e semaforit llogaritet automatikisht sipas parimit të përgjithshëm "vlera positive ndryshimi = jeshile". Kjo rregull zbatohet njëtrajtësisht për të gjithë treguesit dhe mund të japë vizualisht ngjyrë të kuqe edhe në raste kur rezultati real është pozitiv.

Në veçanti, për disa tregues me logjikë të përmbysur, ulja e vlerës absolute përfaqëson përmirësim të performancës. Këtu përfshihen, ndër të tjera:

- • Detyrimet e prapambetura (rënia tregon përmirësim financiar).
- • Shpenzimet administrative (ulja tregon efiçencë).

QELLIMI I RAPORTIT

Raporti i Performancës 2025 synon të ofrojë një pasqyrë të qartë dhe të strukturuar mbi performancën e bashkisë në 11 fusha funksionale. Ky raport përdoret për të ndihmuar vendimmarrjen e bazuar në të dhëna, për të forcuar transparencën dhe llogaridhënien, si dhe për të mundësuar krahasimin ndërmjet bashkive në nivel kombëtar.

Ky raport është përgatitur nga Bashkia Prrenjas, i mandatuar nga Kryetari i Bashkisë në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015, Neni 33, si dhe në kuadër të Sistemit Kombëtar të Matjes së Performancës (SMP 2025).

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI BASHKINË

Bashkia Prrenjas shtrihet brenda territorit të qarkut Elbasan. Rajoni gjendet në pjesën jug-lindore të trungut të brendshëm të vendit dhe ka si kryeqëndër qytetin e Prrenjasit. Në nivel qarku bashkia shtrihet në pjesën jug-lindore dhe kufizohet në veri me bashkinë Librazhd të qarkut Elbasan, ndërsa në lindje me shtetin fqinjë, Maqedoni. Në jug kufizohet me bashkinë Pogradec të Qarkut Korcë dhe në perëndim me bashkinë Gramsh dhe bashkinë Elbasan.

Popullsia: Bashkia Prrenjas ka 33 471 banorë dhe një sipërfaqe prej 323 km2.

Bashkia Prrenjas përbëhet nga 4 njësi administrative: Prrenjas, Qukës, Rrajcë dhe Stravaj.

Bashkia ka nën administrimin e saj 1 (një) qytet dhe 26 (njëzetë e gjashtë) fshatra.

Qyteti ka një ekonomi disi te ekuilibruar, kryesisht të ardhurat sigurohen nga emigrimi në zonat e rajonit përreth dhe nga biznesi i vogël. Pjesë e bashkisë janë edhe disa fshatra turistikë. Zonat rurale merren kryesisht me bujqësi dhe blegtori.

Teritori i Bashkisë shtrihet në zonën malore, mjedisi natyror është i pastër dhe me shumëllojshmëri peisazhesh dhe burime të pasura natyrore dhe ujore. Elementet natyror të njohur janë malet e Sopotit, Rrajcës dhe Shebenikut. Numri i popullsisë i regjistruar sipas censusit të fundit në këtë bashki ka dalë 18,768 banorë. Ndërsa numri popullsisë i regjistruar në gjendjen civile është 33.414 banorë.

Sipas ndarjes administrative Qyteti Prrenjas ka 8,928 banorë ose 26.7%, njësia administrative Qukës ka 10,739 banorë ose 32.1%, Njësia administrative Rrajcë ka 10.890 banorë ose 32.6% dhe njësia administrative Stravaj ka 2.853 banorë ose 8.6 % të popullsisë gjithsej.

Sipërfaqja totale e bashkisë Prrenjas është 323 km 2 ose 0.96 km2 për banorë, sipërfaqe sipas njësive:Njësia administrative Rrajcë 61.2 km2, Njësia administrative Qukës është 126.6 km2 , njësia administrative Stravaj 121. km2 dhe Qyteti Prrenjas bashkë me fshatrat, Prrenjas fshat dhe Rashtan 14.2 km 2.

Zhvillimi i turizmit në këto vite ka qenë dhe vijon të jetë një drejtim i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik për Prrenjasin.

Disa nga sfidat kryesore të zhvillimit janë:

1. Sfida ekonomike

- Varësia e lartë e ekonomisë lokale nga emigracioni dhe të ardhurat e dërguara nga jashtë, që sjellin mungesë stabiliteti ekonomik.
- Niveli i ulët i investimeve private dhe mungesa e sipërmarrjeve të mesme dhe të mëdha.
- Formalizimi i ulët i bizneseve të vogla dhe vështirësia në qasje ndaj financimeve.
- Mungesa e politikave të qëndrueshme për zhvillimin rural dhe modernizimin e bujqësisë.

2. Sfida sociale dhe demografike

- Migracioni masiv i të rinjve drejt qyteteve të mëdha dhe jashtë vendit, që çon në plakje të popullsisë.
- Papunësi e lartë, sidomos te gratë, të rinjtë dhe personat me aftësi të kufizuara.
- Nevoja për rritje të cilësisë së arsimit dhe trajnimeve profesionale për përshtatje me tregun e punës.
- Mungesë e infrastrukturës sociale për fëmijët, të moshuarit dhe grupet vulnerabël.

3. Sfida infrastrukturore

- Rrjeti rrugor, veçanërisht në zonat rurale, ka mungesë mirëmbajtjeje dhe akses të kufizuar gjatë dimrit.

- Nevoja për përmirësim të rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimeve në disa fshatra.
- Mungesë e infrastrukturës turistike dhe shërbimeve mbështetëse për zhvillimin e turizmit rural dhe malor.

4. Sfida mjedisore

- Rreziku i erozionit dhe ndotjes së ujërave për shkak të mungesës së sistemeve të pastrimit.
- Menaxhimi i mbetjeve mbetet një sfidë në zonat rurale dhe turistike.
- Nevoja për përfshirje të komunitetit në mbrojtjen e mjedisit dhe edukimin ekologjik.

5. Sfida të qeverisjes vendore

- Kapasitetet e kufizuara administrative dhe teknike për hartimin dhe zbatimin e projekteve zhvillimore.
- Mungesë koordinimi ndërinstitucional me aktorët rajonalë dhe kombëtarë.
- Nevoja për rritje të transparencës dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse

TË DHËNAT E PËRGJITHSHME TË BASHKISË

E DHËNA	Viti 2024
Popullësia totale nën administrimin e bashkisë	33414
Popullsia në qytet	8928
Popullsia në njësitë administrative	24486
Sipërfaqja totale e bashkisë (në km2)	323
Sipërfaqe publike e bashkisë në km2	59
Sipërfaqja e njësive administrative në total	264
Sipërfaqe totale e fondit pyjor (në ha)	18400
Sipërfaqe totale e fondit kullosor (në ha)	18
Sipërfaqja e tokës bujqësore (në ha)	6086

Numri total i njësive administrative të bashkisë	4
Numri i fshatrave	26
Punonjës të bashkisë në total	319
Numri total i punonjëseve femra të bashkisë	157
Numri total i punonjësve meshkuj të bashkisë	162
Numri total i punonjësve që punojnë për administratën e bashkisë	74
Numri total i punonjësve femra që punojnë për administratën e bashkisë	36

SHERBIME PUBLIKE VENDORE

Ky kapitull paraqet performancën e bashkisë në ofrimin e shërbimeve publike vendore, të cilat përbëjnë thelbin e përgjegjësive të saj sipas Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore". Në këtë kuadër, janë trajtuar gjashtë fusha kryesore te aprovuara edhe ne kuadër të raportit kombëtar të performancës bashkiake, që përfshijnë gjithsej 10 funksione: arsimi parauniversitar (ku hyjnë çerdhet, arsimi parashkollor dhe infrastruktura e godinave arsimore), ujitja dhe kullimi, administrimi i pyjeve dhe kullotave, menaxhimi i mbetjeve, mbrojtja nga zjarri, mbrojtja civile, si dhe mbrojtja sociale, e cila përfshin katër shërbime të detyrueshme sipas nenit 24 të ligjit.

Matja e performancës në këto fusha bazohet në tregues të standardizuar sipas SMP Kombëtar, tregues të tjerë vendor që janë përzgjedhur nga bashkia, si dhe nën-tregues të detajuar, të cilët ofrojnë një pasqyrë të qartë mbi aksesin e qytetarëve në shërbime, cilësinë dhe kapacitetet e tyre, si dhe barazinë në ofrim ndërmjet grupeve të ndryshme shoqërore. Përmes këtij sistemi, bashkia ka mundësi të identifikojë përparimet e arritura, sfidat e mbetura dhe nevojat për përmirësim në ofrimin e shërbimeve themelore për komunitetin.

ARSIMI PARAUNIVERSITAR

Përshkrim i përgjithshëm: Arsimi parauniversitar në nivel vendor përfshin shërbimet e arsimit të hershëm (çerdhe dhe kopshte), arsimin bazë 9-vjeçar dhe arsimin e mesëm të përgjithshëm. Kompetencat për administrimin dhe zhvillimin e këtij sektori janë të deleguara te njësitë e vetëqeverisjes vendore sipas Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore". Dy funksionet kryesore që rregullojnë këtë fushë janë:

- Funksioni 23.11: "Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale."

Funksioni 23.12: "Administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe."

Në këtë kuadër, bashkitë janë përgjegjëse njëkohësisht për aspektet infrastrukturore dhe menaxheriale të institucioneve arsimore nën juridiksionin e tyre. Kjo përfshin ndërtimin dhe mirëmbajtjen e objekteve shkollore (23.11), si dhe administrimin e plotë të sistemit parashkollor (kopshte dhe çerdhe) përmes funksionit 23.12, që përfshin menaxhimin e stafit ndihmës, mbështetjen logjistike dhe rregullimin funksional të shërbimit.

Sektori I arsimit parauniversitar prezantohet me 5 tregues dhe 7 nentregues. **Shkalla e regjistrimit në çerdhe publike** është rritur nga **3.5%** në **3.7%** (**+0.2 pp**,), me një rritje më të dukshme tek djemtë (**+0.6 pp**) ndërkohë që tek vajzat ka një ulje të lehtë (**-0.3 pp**).

Në të kundërt, **shkalla e regjistrimit në kopshte publike dhe private qe perfaqsohet vetem nga kopshtet publike,** ka pesuar rënie nga **33.6%** në **32.1%** (**-1.5 pp**). Kjo renie nuk shoqerohet me diferenca gjinore. Tek vajzat rënia ka qenë (**-2.6 pp**), ndërsa tek djemtë (**-0.5 pp**).

Raporti fëmijë–mësues në kopshtet publike është rritur lehtë nga **15.1** në **15.2 nxënës për mësues** (**+1%**), duke treguar stabilitet në raportin mes numrit të fëmijëve dhe edukatorëve.

Në aspektin e infrastrukturës, **numri i godinave arsimore sipas nivelit arsimor** është rritur nga **45** në **46**, duke reflektuar një shtim prej **+2%**. Ky zhvillim tregon për përmirësim gradual të kapaciteteve. Ndërkohë, **plani vendor i arsimit parauniversitar** vijon të mungojë, duke mbetur i pa miratuar në të dy vitet.

Në tërësi, fotografia tregon **rritje të lehtë të regjistrimit në çerdhe dhe zgjerim të infrastrukturës**, por edhe **nje shkallës së regjistrimit në kopshte**, qe sinjalizon nevojën për përforcim të politikave nxitëse dhe planifikim të integruar.

A) Tabela përmbledhëse

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Shkalla e regjistrimit në çerdhe publike	%	3.50	3.71	0.21	↑	Përmirësuar	🟢	
Tregues	Shkalla e regjistrimit në kopshte publike dhe private	%	33.62	32.09	-1.53	↓	Përkeqësuar	🔴	-
Tregues	Plani Vendor i Arsimit Parauniversitar	Po/Jo	0.00	0.00	0.00	→	Pa ndryshim	🟠	
Tregues	Godina Arsimore sipas nivelit arsimor	numër	45.00	46.00	1.00	↑	Përmirësuar	🟢	2%
Nen-tregues	Shkalla e regjistrimit të vajzave në çerdhe publike	%	4.57	4.33	-0.25	↓	Përkeqësuar	🔴	-
Nen-tregues	Shkalla e regjistrimit të djemve në çerdhe publike	%	2.49	3.10	0.61	↑	Përmirësuar	🟢	
Nen-tregues	Shkalla e regjistrimit të vajzave në kopshte publike	%	35.18	32.56	-2.62	↓	Përkeqësuar	🔴	-
Nen-tregues	Shkalla e regjistrimit të djemve në kopshte publike	%	32.10	31.63	-0.47	↓	Përkeqësuar	🔴	-
Nen-tregues	Godina Arsimore publike sipas nivelit arsimor	numër	45.00	45.00	0.00	→	Pa ndryshim	🟠	0%
Nen-tregues	Shkalla e regjistrimit në kopshte publike	%	33.62	32.09	-1.53	↓	Përkeqësuar	🔴	
Nen-tregues	Raporti fëmijë-mësues në kopshte publike	nxënës/mësues	15.07	15.17	0.10	↑	Përmirësuar	🟢	1%

B) Shtojcë: Të dhënat burim

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Numri i fëmijëve të moshës nga 6 muaj-3 vjeç në bashki	1713.00	1726.00	Numër
Numri i fëmijëve të moshës 6 muaj deri në 3 vjeç të regjistruar në çerdhe publike	60.00	64.00	Numër
Numri i fëmijëve të moshës nga 3–6 vjeç në bashki	1972.00	1985.00	Numër
Numri i fëmijëve të moshës 3-6 vjeç që frekuentojnë kopshtet publike	663.00	637.00	Numër
Numri i fëmijëve të moshës 3-6 vjeç që frekuentojnë kopshtet private	0.00	0.00	Numër
Numri i edukatorëve në kopshte publike	44.00	42.00	Numër
Numri i edukatorëve në kopshte private	0.00	0.00	Numër
Numri i çerdheve publike në bashki	1.00	1.00	Numër
Numri i çerdheve private në bashki	0.00	0.00	Numër
Numri i kopshteve publike në bashki	24.00	24.00	Numër
Numri i kopshteve private në bashki	0.00	0.00	Numër
Numri i shkollave 9-vjeçare publike në bashki	14.00	14.00	Numër
Numri i shkollave 9-vjeçare private në bashki	0.00	0.00	Numër
Numri i shkollave të mesme të përgjithshme publike në bashki	6.00	6.00	Numër
Numri i shkollave të mesme të përgjithshme private në bashki	0.00	1.00	Numër
Plani vendor i Arsimit Parauniversitar, I miratuar ose zbatuar	0.00	0.00	Po/Jo

Sfida	Arritje	Objektiva
-Shkallë e shumë e ulët e mbulimit me shërbim të çerdhes dhe arsimit parashkollor; -Mungesë e institucioneve parashkollore private	•Rritje e pjesëmarrjes në arsimin parashkollor • Staf mësimor i stabilizuar	• Përmirësim i kushteve infrastrukturore • Zbatimi i planeve vjetore për cilësinë mësimore



MENAXHIMI I MBETJEVE

Përshkrim i përgjithshëm: Bashkitë janë përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve urbane dhe mbrojtjen e mjedisit në territorin e tyre. Ky funksion përfshin të gjitha aspektet që lidhen me mbledhjen, largimin, transportin, trajtimin dhe depozitimin e mbetjeve, si dhe mirëmbajtjen e pastërtisë në hapësirat publike si rrugët, sheshet, tregjet dhe parqet. Nëpërmjet këtij funksioni,

bashkitë sigurojnë krijimin dhe operimin e sistemeve vendore për menaxhimin e mbetjeve, duke përfshirë strukturat teknike, logjistikën, kontraktimin e subjekteve private dhe kontrollin e zbatimit të standardeve mjedisore. Shembuj të aktiviteteve përfshijnë: Mbikëqyrjen dhe funksionimin e sistemeve për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve; Pastrimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike (rrugë, parqe, tregje, kopshte publike); Dhënien e granteve ose fondeve për investime në infrastrukturën e mbetjeve; Monitorimin e ndotjes dhe koordinimin me institucionet për mbrojtjen e mjedisit. Ky funksion rrjedh nga Ligji Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 23, i cili i njeh bashkive kompetencën për menaxhimin e shërbimeve publike vendore, përfshirë menaxhimin e mbetjeve urbane dhe mirëmbajtjen e pastërtisë publike.

Analiza e sherbimit

Sektori i Menaxhimit të Mbetjeve prezantohet me 4 tregues dhe 2 nentregues.

Klasifikimi teknik

- Përmirësuar (1)
  - Mbulimi i kostos së shërbimit nga tarifa: 35.2% (2023) → 45.9% (2024), +10.7 pp
- Pa ndryshim (4)
  - Mbulimi i popullsisë me shërbimin: 68.8% → 68.8% (0 pp)
  - Mbulimi urban: 75% → 75% (0 pp)
  - Mbulimi rural: 62.5% → 62.5% (0 pp)
  - Plani vendor i mbetjeve: në fuqi në të dy vitet (0 ndryshim)
- Përkeqësuar (1)
  - Mbetjet e gjeneruara për banor: 86.4 kg → 51.8 kg (-40%)

Interpretimi

- Bilanci: Teknikisht, 1 tregues i përmirësuar, 4 pa ndryshim dhe 1 përkeqësuar.
- Rezultate pozitive: Mbulimi i kostos së shërbimit nga tarifa është rritur ndjeshëm (nga 35.2% në 45.9%), duke forcuar qëndrueshmërinë financiare. Mbulimi urban dhe rural mbetet i plotë dhe i qëndrueshëm. Plani vendor i menaxhimit të mbetjeve është i miratuar dhe aktiv.
- Treguesi i mbetjeve për banor: edhe pse klasifikohet si "përkeqësim" për shkak të rënies me 40%, ky rezultat mund të ketë një interpretim neutral/pozitiv, sepse ulja e raportuar lidhet me më pak sasi mbetjesh të gjeneruara për frymë, gjë që në praktikë është e dëshirueshme për mjedisin.


A) Treguesit përmbledhës

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në zonat urbane/rurale	%	68.75	68.75	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Tregues	Mbetjet e gjeneruara si kg/banor	kg/banor	86.42	51.75	-34.67	↓	Përkeqësuar	●	-40%
Tregues	Mbulimi kostos së menaxhimit të mbetjeve nga tarifa e shërbimit	%	35.20	45.90	10.70	↑	Përmirësuar	●	30%
Tregues	Plani vendor I menaxhimit të mbetjeve I miratuar ose në zbatim	Numër	1.00	1.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Nen-tregues	Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në zonat urbane	%	75.00	75.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Nen-tregues	Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në zonat rurale	%	62.50	62.50	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%

A) Te Dhenat

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Numri njësive administrative qendër (qytete) të mbuluar me shërbimin e mbetjeve	3.00	3.00	Numër
Numri njësive administrative qendër (qytete) të bashkisë	4.00	4.00	Numër
Numri fshtrave të mbuluar me shërbimin e mbetjeve	15.00	15.00	Numër
Numri fshatrave në territorin e bashkise	24.00	24.00	Numër

Sasia e mbetjeve të gjeneruara gjithsej	2369000.00	1464900.00	Kg
Të ardhurat gjithsej nga tarifa e shërbimit të mbetjeve	10139.00	13395.16	mijë Lekë
Shpenzime gjithsej për ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve	28804.00	29182.05	mijë Lekë
Plani i miratuar ose zbatuar gjatë vitit të raportimit	1.00	1.00	Cilësore (Po/Jo)
Popullsia e përgjithshme e bashkisë	27414.00	28307.00	Numër



Sfida	Arritje	Objektiva
• Mungesë mbulimi në zonat rurale • Ndërgjegjësim i ulët për ndarjen në burim	• Shërbim i qëndrueshëm në qendër • Përdorim i rregullt i pikave të grumbullimit	• Zgjerim i mbulimit në fshatra • Fillimi i ndarjes në burim

MBROJTJA NGA ZJARRI

Përshkrim i përgjithshëm: Bashkitë kanë përgjegjësi për garantimin e shërbimit zjarrëfikës në nivel vendor dhe për administrimin e strukturave përkatëse të parandalimit dhe mbrojtjes

kundër zjarrit. Ky funksion synon të sigurojë reagim të shpejtë dhe efektiv në raste emergjencash, si dhe të ndërtojë kapacitete vendore për parandalimin e zjarreve në mjedise urbane, rurale dhe pyjore. Përgjegjësitë e bashkive përfshijnë operimin dhe mirëmbajtjen e njësive zjarrëfikëse, organizimin e shërbimeve parandaluese, si dhe bashkëpunimin me strukturat qendrore për raste që tejkalojnë kapacitetet vendore. Bashkitë gjithashtu angazhohen në edukimin e komunitetit dhe trajnimin e stafit për reagim dhe menaxhim të rreziqeve nga zjarret. Aktivitete përfaqësuese përfshijnë : - - - - Funksionimi dhe pajisja e njësive zjarrëfikëse dhe shërbimeve të emergjencës; Zbatimi i masave të parandalimit në ndërtesa publike dhe hapësira komunitare; Trajnimi i stafit vendor dhe vullnetarëve për ndërhyrje dhe evakuim; Mbështetja e fushatave sensibilizuese për komunitetin në lidhje me rreziqet nga zjarri

TREGUESIT E PERFORMANCËS

A) Treguesit përmbledhës


Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Zjarrëfikës për 1,500 banorë	punonjës/1500 banorë	0.77	0.74	-0.02	↓	Përkeqësuar	●	-3%
Tregues	Automjete zjarrëfikëse për 10,000 banorë	mjete/10000 banorë	0.36	0.35	-0.01	↓	Përkeqësuar	●	-3%


B) Shtojcë: Të dhënat burim

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Numri i punonjësve zjarrëfikës në bashki	14.00	14.00	Numër
Popullsia e përgjithshme e bashkisë	27414.00	28307.00	Numër
Numri i mjeteve zjarrëfikëse funksionale në bashki	1.00	1.00	Numër

Analiza E SHËRBIMIT

Sektori i Mbrojtjes nga Zjarri prezantohet me 2 tregues.
Teknikisht të dy treguesit tregojnë përkeqësim, pasi kemi pasur rritje te numrit te banorëve.
Numri i mjeteve zjarrfikëse dhe numri i punonjësve zjarrfikës kanë mbetur të pandryshuara.





Sfida	Arritje	Objektiva
• Mbulim i pjesshëm i territorit pyjor • Logjistikë e kufizuar	• Qendrueshmeri ne kapacitete (14 punonjës, 4 mjete) • Zbatim i planeve parandalues	• Rritje e stafit dhe pajisjeve • Trajnime të përvitshme për emergjencat

MENAXHIMI I INFRASTRUKTURËS SË UJITJES DHE KULLIMIT

Përshkrim i përgjithshëm: Funksioni për mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit është pjesë e kompetencave të deleguara të NJVV-të sipas Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", konkretisht neni 27 pika 1. Ky funksion përfshin ndërtimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të ujitjes dhe kullimit në territorin e bashkisë, si dhe përgatitjen e planeve vendore për menaxhimin e qëndrueshëm të rrjeteve përkatëse. Qëllimi i këtij funksioni është mbështetja e zhvillimit të qëndrueshëm të prodhimit bujqësor dhe mbrojtja e konsumatorëve përmes garantimit të furnizimit me ujë për vaditje dhe menaxhimit të ujërave të tepërta në zonat bujqësore.

TREGUESIT E PERFORMANCËS

A) Treguesit përmbledhës

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Tokë bujqësore e pajisur me kanale ujitje/kullimi	%	32.53	32.53	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Tregues	Përqindja e kanaleve ujitëse dhe kulluese funksionale	%	80.13	80.13	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Nen-tregues	Përqindja e kanaleve ujitëse funksionale	%	85.78	85.78	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Nen-tregues	Përqindja e kanaleve kulluese funksionale	%	74.47	74.47	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%

B) Shtojcë: Të dhënat burim


E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Sipërfaqja gjithsej e tokës bujqësore në bashki	3892.00	3892.00	Hektarë
Sipërfaqja e tokës bujqësore e mbuluar me kanale ujitje dhe/ose kullimi	1266.00	1266.00	Hektarë
Gjatësia e kanaleve ujitëse	211.00	211.00	Kilometër (km)
Gjatësia e kanaleve ujitëse funksionale	181.00	181.00	Kilometër (km)
Gjatësia e kanaleve kulluese	47.00	47.00	Kilometër (km)
Gjatësia e kanaleve kulluese funksionale	35.00	35.00	Kilometër (km)

Analiza e SHËRBIMiT

Sistemi i ujitjes dhe kullimit në bashki ka mbetur i qëndrueshëm midis viteve 2023 dhe 2024. Tokë bujqësore e mbuluar me kanale ujitje dhe kullimi ka mbetur në 32.5% (0 pp ndryshim), që përfaqëson 1,266 ha nga një total prej 3,892 ha tokë bujqësore.

Në të njëjtën linjë, përqindja e kanaleve ujitëse dhe kulluese funksionale është mbajtur e pandryshuar në 80.1%, duke treguar që 181 km nga 211 km të kanaleve ujitëse dhe 35 km nga 47 km të kanaleve kulluese janë në gjendje funksionale.

Këto të dhëna pasqyrojnë një stabilitet të plotë të infrastrukturës ekzistuese të ujitjes dhe kullimit, pa ndryshime mes dy viteve.



Fusha	Sfida	Arritje	Objektiva
Ujitja dhe Kullimi	• Rrjete të amortizuara në disa zona bujqësore • Nevojë për financim të mirëmbajtjes	• Ruajtje e infrastrukturës ekzistuese • Funksionalitet i plotë i kanaleve kryesore	• Hartimi i planit të menaxhimit të rrjeteve • Rritja e sipërfaqes së ujitshme

ADMINISTRIMI I PYJEVE DHE KULLOTAVE

Përshkrim i përgjithshëm : Funksioni i menaxhimit të pyjeve dhe kullotave, sipas nenit 27, pika 5 të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i është deleguar bashkive me qëllim administrimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të fondit pyjor dhe kullosor publik që ndodhet brenda territorit të NJVV-ve. Bashkitë janë përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e planeve të mbarështimit për fondet, monitorimin e tyre dhe për sigurimin e mbrojtjes kundër dëmtimeve, ndotjes apo zjarreve, në përputhje me legjislacionin për pyjet dhe kullotat.

Analiza e Sherbimit

- Plan vendor i miratuar: në fuqi në të dy vitet (pa ndryshim).
- Shkalla e pajisjes me plane mbarështimi: është rritur nga 26.1% → 31.4% (+5.2 pp), duke treguar përmirësim të dukshëm në mbulimin e sipërfaqes me plane të miratuara.
- Punonjës për 1,000 ha: ka mbetur praktikisht i qëndrueshëm (0.72 → 0.71). Me 13 punonjës për një sipërfaqe prej 18,400 ha, standardi minimal prej 1 punonjësi për 1,500 banorë përmbushet.

Bashkia ka arritur të ruajë strukturën e personelit dhe të mbulojë të gjithë territorin pyjor/kullosor sipas standardit, duke garantuar funksionalitet në menaxhim. Përmirësimi në shkallën e planeve të mbarështimit tregon angazhim për menaxhim afatgjatë të qëndrueshëm. Sfida mbetet konsolidimi i burimeve njerëzore për të rritur më tej shkallën e zbatimit praktik të planeve.

TREGUESIT E PERFORMANCËS


A) Treguesit përmbledhës

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Plan Vendor Mbarështimi I miratuar ose zbatuar	Cilësore (Po/Jo)	1.00	1.00	0.00	→	Pa ndryshim	🟠	0%
Tregues	Shkalla e pajisjes me plane mbarështimi	%	26.14	31.38	5.24	↑	Përmirësuar	🟢	20%
Tregues	Punonjës për 1,000 hektarë	punonjës/ 1000 ha	0.72	0.71	-0.02	↓	Përkeqësuar	🔴	-2%

B) Shtojcë: Të dhënat burim

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Plan Vendor Mbarështimi I miratuar ose zbatuar	1.00	1.00	Cilësore (Po/Jo)
Sipërfaqja gjithsej e fondit pyjor dhe kullosor në bashki	18000.00	18400.00	Hektarë
Sipërfaqja e fondit pyjor dhe kullosor e mbuluar me plan mbarështimi	4706.00	5774.00	Hektarë
Numri i punonjësve për menaxhimin e fondit pyjor dhe kullosor	13.00	13.00	Numër

Fusha	Sfida	Arritje	Objektiva
Pyjet dhe Kullotat	• Mungesë burimesh njerëzore për zbatim në terren • Rrezik nga zjarret dhe dëmtimet	• Rritje e shkallës së planeve të mbarështimit (26% → 31%) • Strukturë funksionale e personelit	• Konsolidim i burimeve njerëzore • Zbatim i plotë i planeve të miratuara



MBROJTJA SOCIALE

Përshkrim i përgjithshëm: Bashkitë janë përgjegjëse për krijimin, administrimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale vendore për individët dhe familjet në nevojë, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara, fëmijët pa përkujdesje prindërore, të moshuarit, viktimat e dhunës dhe trafikimit, si dhe grupet e tjera vulnerabël. Shërbimet përfshijnë ndihma financiare dhe në natyrë, mbështetje për strehim dhe përfshirje sociale, si dhe funksionimin e qendrave ditore apo rezidenciale. Qëllimi i tyre është të lehtësojnë jetesën dhe të nxisin integrimin e qytetarëve në komunitet. Ndër shërbimet kryesore përfshihen: pagesat për kujdestari dhe lindje, ndihma për energji dhe nevoja bazë, shërbime për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara, mbështetje në kushte emergjente, strehim të përkohshëm dhe përkujdesje në shtëpi, si dhe masa për riintegrimin e të papunëve në tregun e punës. Bashkitë gjithashtu bashkëpunojnë me Organizata jo Fitimprurëse (OJF) dhe sektorin privat për ofrimin e këtyre shërbimeve në territor.

Analiza e Sherbimit

1. Ndihma ekonomike:
    - Përqindja e familjeve përfituese ka rënë nga 47.3% → 40.2% (-7.1 pp).
    - Ulja reflekton rënie të numrit absolut të përfituesve (430 → 347), edhe pse aplikimet mbeten të larta (910 → 863).
2. Strehimi social:
    - Shkalla e miratimit ka rënë nga 86.2% → 69.8% (-16.4 pp).Megjithatë, numri absolut i përfituesve është rritur (75 → 90), pra kërkesa është shtuar edhe më shumë (87 → 129).
3. Qendrat sociale:
    - Numri i qendrave për 10,000 banorë ka mbetur praktikisht i njëjtë (0.73 → 0.71), pasi nuk janë hapur qendra të reja.
4. Rastet e dhunës:
    - Numri i rasteve të dhunës të referuara është rritur (28 → 30).
    - Disaggregimi tregon se shumica e rasteve janë të grave, por edhe meshkujt dhe grupmoshat e reja po referohen më shpesh. Pothuajse të gjitha rastet e referuara kanë marrë shërbime sociale (edhe pse raporti zbriti nga 100% → 83%).
5. Personat me aftësi të kufizuar (PAK):
    - Numri i PAK të referuar është rritur ndjeshëm (695 → 750), dhe po ashtu ata që marrin mbështetje (685 → 736).
    - Diferenca gjinore: femrat PAK që marrin mbështetje janë rritur nga 320 → 345, ndërsa meshkujt PAK nga 365 → 391.
    - Diferenca sipas moshës: 0-17 vjeç 225 → 243, ndërsa 18+ vjeç 460 → 493.

- Pra, të dy gjinitë dhe të dy grupmoshat kanë përfituar rritje, megjithëse pjesa më e madhe e mbështetjes vijon të shkojë për moshat e rritura.

A) Treguesit përmbledhës

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Përqindja e familjeve që marrin ndihmë ekonomike	%	47.25	40.21	-7.04	↓	Përkeqësuar	🔴	
Tregues	Shkalla e miratimit të strehimit social	%	86.21	69.77	-16.44	↓	Përkeqësuar	🔴	
Tregues	Numri i qendrave sociale komunitare publike, te licensuara për 10,000 banorë	qendra/10,000 banore	0.73	0.71	-0.02	↓	Përkeqësuar	🔴	-3%
Tregues	Përqindja e rasteve të referuara nga mekanizmi i koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale	%	100.00	83.33	-16.67	↓	Përkeqësuar	🔴	-
Tregues	Përqindja e personave me aftësi të kufizuar, të referuar nga komisionet bio-psiko-sociale që marrin mbështetje sociale të integruara	%	98.56	98.13	-0.43	↓	Përkeqësuar	🔴	
Tregues	Plan vendor social	Cilësore (Po/Jo)	1.00	1.00	0.00	→	Pa ndryshim	🟠	0%

B) Shtojcë: Të dhënat burim

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Numri i familjeve që kanë aplikuar për ndihmë ekonomike	910.00	863.00	Numër
Numri i familjeve përfituese të ndihmës ekonomike	430.00	347.00	Numër
Popullsia e përgjithshme e bashkisë	27414.00	28307.00	Numër
Numri i personave që kanë paraqitur kërkesë për strehim social	87.00	129.00	Numër
Numri i personave përfitues të strehimit social	75.00	90.00	Numër
Numri i qendrave sociale ditore funksionale	2.00	2.00	Numër
Numri i qendrave sociale rezidenciale funksionale	0.00	0.00	Numër
Numri i rasteve të dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës të referuara nga Mekanizmit i Koordinuar i Referimit	28.00	30.00	Numër
Numri i rasteve të dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës të referuara nga antarët e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (MKR), të cilat kanë përfituar shërbime sociale	28.00	25.00	Numër
Numri i PAK të referuar nga shërbimet bio-psiko-sociale për të marrë shërbime sociale	695.00	750.00	Numër
Numri i PAK që marrin mbështetje si pasojë e referimit	685.00	736.00	Numër
Plani Vendor Social, i miratuar apo zbatuargjatë periudhës së raportimit	1.00	1.00	Cilesore(Po=1/Jo=0)

Sfida	Arritje	Objektiva
• Rënie e lehtë e përfituesve të ndihmës ekonomike	• Mbulim pothuaj i plotë i PAK • Përmirësim në mekanizmin e referimit	• Zgjerimi i shërbimeve komunitare

QEVERISJA E MIRE

Qeverisja e mirë përfaqëson aftësinë institucionale të bashkisë për të ushtruar përgjegjësitë publike me integritet, transparencë dhe efikasitet, duke garantuar përfshirjen qytetare dhe barazinë e mundësive. Në kuadër të matjes së performancës vendore, qeverisja e mirë vlerësohet përmes katër fushave përfaqësuese, të cilat reflektojnë cilësinë e proceseve të brendshme dhe kapacitetin administrativ për të siguruar rezultate të qëndrueshme:

1. 👥 Burimet Njerëzore – masin strukturën, stabilitetin dhe profesionalizmin e administratës vendore, si dhe nivelin e zhvillimit të kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve cilësore.
2. 📖 Transparenca – tregon nivelin e hapjes së informacionit dhe komunikimit me qytetarët, publikimin e akteve dhe respektimin e standardeve të qeverisjes së hapur.
3. ⚖️ Barazia Gjinore – reflekton përpjekjet institucionale për të siguruar përfaqësim të barabartë dhe përfshirje gjinore në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe politikëbërjes lokale.
4. EU Integrimi në BE – mat aftësinë e bashkisë për të përafruar praktikat e saj me standardet evropiane, përmes projekteve bashkëpunuese, partneriteteve ndërbashkiake dhe strukturave të dedikuara të integrimit..

BURIMET NJERËZORE

Përshkrim i përgjithshëm: Bashkitë kanë rol të rëndësishëm në menaxhimin e burimeve njerëzore për administratën vendore dhe strukturat e varësisë. Ky funksion përfshin planifikimin, organizimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të stafit, si dhe ndjekjen e dinamikave të personelit – duke përfshirë rekrutimin, rotacionin, trajnimin dhe raportimin vjetor të të dhënave mbi stafin aktiv dhe të larguar. Qëllimi është të sigurohet një trupë administrative efektive, e kualifikuar dhe në përputhje me nevojat e ofrimit të shërbimeve publike vendore. Përmes këtij funksioni, bashkia ndjek tregues si numri i punonjësve për 1,000 banorë, përqindja e stafit të trajnuar, si dhe lëvizjet vjetore të stafit sipas gjinisë dhe njësisë strukturore (administratë ose njësi shpenzuese).

Analiza e Sherbimit

- Reduktimi i rotacionit të stafit: Edhe pse sistemi e kategorizon si përkeqësim (sepse ka shenjë negative), në fakt është një zhvillim pozitiv, pasi më pak punonjës janë larguar (36 në vitin 2023 → 32 në vitin 2024).
- Stabilitet në trajnime: Numri absolut i punonjësve të trajnuar ka mbetur 50, por raporti për meshkujt është rritur, ndërsa për femrat ka pasur një ulje të lehtë. Në total, niveli i trajnimit ka mbetur i qëndrueshëm.
- Punonjës për 1,000 banorë: Ka një ulje të lehtë (-8%), duke kaluar nga 12.22 në 11.27. Kjo tregon një optimizim të strukturës së stafit, sidomos pasi popullsia e bashkisë është rritur ndërkohë.

Në total, nga 11 tregues, 3 tregues dhe 8 nentregues tregojnë përmirësim të qartë dhe 8 janë të klasifikuar si negativë sipas sistemit. Megjithatë, disa prej tyre – si ulja e rotacionit – në interpretim janë pozitive, pasi pasqyrojnë stabilitet më të madh të stafit.

Panorama e përgjithshme tregon një administratë që po konsolidohet, me më pak lëvizje të stafit, përfshirje më të madhe të meshkujve në trajnime dhe një nivel të qëndrueshëm të punonjësve për 1,000 banorë, pavarësisht rritjes së popullsisë.

TREGUESIT E PERFORMANCËS

A) Treguesit përmbledhës

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Shkalla e rotacionit të punonjësve të bashkisë	%	11.08	10.03	-1.05	↓	Përkeqësuar	🔴	-9%
Tregues	Përqindja e stafit të punësuar nga bashkia të trajnuar	%	15.38	15.67	0.29	↑	Përmirësuar	🟢	2%
Tregues	Punonjës për 1000 banorë	punonjës/1,000 banorë	12.22	11.27	-0.95	↓	Përkeqësuar	🔴	-8%

B) Shtojcë: Të dhënat burim

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Numri i punonjësve në bashki gjatë vitit të raportimit	325.00	319.00	Numër
Numri i punonjësve të larguar nga bashkia gjatë vitit të raportimit	36.00	32.00	Numër
Popullsia e përgjithshme e bashkisë	27414.00	28307.00	Numër
Numri i punonjësve të trajnuar gjatë vitit	50.00	50.00	Numër
Numri i punonjësve të shërbimeve të nënkontraktuara në bashki gjatë vitit të raportimit	10.00	0.00	Numër

Sfida	Arritje	Objektiva
• Nevojë për trajnime të vazhdueshme	• Rritje e stafit të trajnuar (9 → 20) • Stabilitet në strukturë (rotacion i ulet)	• Vijim i trajnimeve dhe formimit profesional te strukturave

TRANSPARENCA

Përshkrim i përgjithshëm : Transparenca dhe llogaridhënia janë elementë thelbësorë të qeverisjes së mirë në nivel vendor. Bashkitë kanë detyrimin të sigurojnë pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin vendimmarrës, të publikojnë informacionin mbi veprimtarinë institucionale dhe të japin llogari për realizimin e detyrave të tyre. Këto parime përforcojnë besimin e publikut, përmirësojnë shërbimet dhe parandalojnë abuzimet me pushtetin.

Në këtë kuadër, bashkitë duhet të garantojnë : (i) zhvillimin e konsultimeve publike për aktet me ndikim në komunitet ; (ii) publikimin e vendimeve të Këshillit Bashkiak dhe dokumenteve të rëndësishme si Plani Buxhetor Afatmesëm, Paketa Fiskale dhe raportet vjetore të transparencës ; (iii) hartimin dhe zbatimin e planeve të integritetit për të forcuar etikën institucionale.

TREGUESIT E PERFORMANCËS


A) Treguesit përmbledhës


Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Akte për të cilët është i detyrueshëm zhvillimi i konsultimit publik	%	100.00	100.00	0.00	→	Pa ndryshim	🟠	0%
Tregues	Raporti vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes	Cilësore (Po/Jo)	1.00	1.00	0.00	→	Pa ndryshim	🟠	0%
Tregues	Plani Vendor i Integritetit	Cilësore (Po/Jo)	0.00	1.00	1.00	↑	Përmirësuar	🟢	

C) Shtojcë: Të dhënat burim (Tbl_TeDhenat)

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Numri i akteve gjithsej për të cilat është i detyrueshëm zhvillimi i konsultimit publik	3.00	4.00	Numër
Numri i akteve për të cilët është zhvilluar konsultimi publik	3.00	4.00	Numër
Publikimi i raportit vjetor për transparencën	1.00	1.00	Cilësore (Po=1/Jo=0)
Plani Vendor i Integritetit, i miratuar ose zbatuar gjatë periudhës së raportimit	0.00	1.00	Cilësore (Po=1/Jo=0)

Sfida	Arritje	Objektiva
• Përdorim i kufizuar i kanaleve online • Mungesë ndërveprimi publik në konsultime	• Publikim i rregullt i akteve • Përmirësim i raportimit financiar	• Zhvillim i platformës online të transparencës • Rritje e pjesëmarrjes qytetare





BARAZIA GJINORE

Përshkrim i përgjithshëm: Barazia gjinore në qeverisjen vendore është një element kyç për ndërtimin e institucioneve demokratike, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse. Ajo nënkupton jo vetëm balancën në përfaqësim midis grave dhe burrave në pozicione drejtuese, por edhe integrimin sistematik të perspektivës gjinore në të gjitha proceset vendimmarrëse, politikat publike dhe ofrimin e shërbimeve. Në këtë kontekst, bashkitë duhet të garantojnë: • pjesëmarrje të barabartë gjinore në strukturat vendimmarrëse dhe administrative; • buxhetim të përgjigjshëm gjinor (gender-responsive budgeting), sipas parashikimeve në legjislacionin në

fuqi; • ofrim shërbimesh që adresojnë në mënyrë të barabartë nevojat e ndryshme të grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve, në të gjithë diversitetin e tyre; • mekanizma për mbrojtjen nga diskriminimi gjninor, diskriminimi për shkak të përkatësisë së shumëfishtë (intersectional discrimination) dhe dhuna me bazë gjinore. Bashkitë janë të detyruara të raportojnë jo vetëm për përfaqësimin gjinor në pozicione kyçe, por edhe për masat e marra për të zbatuar barazinë gjinore në praktikë, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe angazhimet ndërkombëtare.

Analiza e fushes

Përfaqësimi i grave në pozicionet politike dhe drejtueset kryesore (kryetare, zv.kryetare, këshill bashkiak, administratore) ka rënë ndjeshëm nga 53.9% në 30.8%, një ulje prej -23.1 pp. Ky ndryshim tregon dobësim të përfaqësimit gjinor në nivelet më të larta.

Nga ana tjetër, përqindja e grave në pozicione drejtuese të ndryshme të administratës është rritur nga 28.9% në 32.4% (+3.4 pp), duke treguar progres në nivelet menaxheriale dhe teknike të bashkisë.

Ndërkohë, Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore vijon të mungojë në të dy vitet, duke mbetur një boshllëk në aspektin strategjik.

TREGUESIT E PERFORMANCËS


A) Treguesit përmbledhës

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Përqindja e grave në pozicione: kryetare, zv.kryetare, anëtare në këshill bashkiak dhe administratore	%	53.85	30.77	-23.08	↓	Përkeqësuar	🔴	
Tregues	Përqindja e grave në pozicione drejtuese të ndryshme (të lartë, të mesme, të ulët) në bashki	%	28.95	32.35	3.41	↑	Përmirësuar	🟢	
Tregues	Plan Vendor Veprimi për Barazinë Gjinore	Cilësore (Po/Jo)	0.00	0.00	0.00	→	Pa ndryshim	🟠	


TË DHËNAT

C) Shtojcë: Të dhënat burim

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Numri gjithsej i pozicioneve drejtuese në bashki (Kryetare/Kryetar Bashkie, zv.Kryetare/zv.Kryetar Bashkie, Administratore/Administrator, Anëtare/Anëtarë në Këshill Bashkiak).	26.00	26.00	Numër
Numri i grave në pozicione drejtuese në bashki: Kryetare, zv.Kryetare, Anëtare në Këshill Bashkiak dhe Administratore	14.00	8.00	Numër
Numri i pozicioneve drejtuese të ndryshme (të lartë, të mesme, të ulët)	38.00	34.00	Numër
Numri i grave në pozicione drejtuese të ndryshme (të lartë, të mesme, të ulët)	11.00	11.00	Numër
Plan Vendor Veprimi për Barazinë Gjinore, i miratuar ose zbatuar gjatë periudhës së raportimit	0.00	0.00	Cilësore (Po/Jo).



Sfida	Arritje	Objektiva
• Mungesë të dhënash të disagreguara gjinore • Niveli i ulët i grave në drejtim	• Rritje e pjesëmarrjes në trajnime • Rritje e grave në pozicione drejtuese (8 → 10)	• Hartimi dhe zbatimi i planit vendor për barazi gjinore



EU INTEGRIMI NË BE

Përshkrim i përgjithshëm: Integrimi në Bashkimin Evropian nuk është vetëm një detyrë e qeverisjes qendrore, por një proces i përbashkët që përfshin të gjitha nivelet e administratës publike, përfshirë pushtetin vendor. Bashkitë luajnë një rol kritik në afërsimin me acquis communautaire dhe përmbushjen e kritereve të anëtarësimit, përmes politikave dhe shërbimeve që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve. Në këtë kuptim, bashkive u rekomandohet të:

• Ndërtojnë kapacitete administrative për të përthithur dhe zbatuar fondet e BE-së;

• Zhvillojnë plane vendore për përputhshmëri me politikat e BE-së në fusha si mjedisi, energjia, digjitalizimi, barazia gjinore, migracioni, zhvillimi rural dhe përfshirja sociale;

• Fuqizojnë rolin e komuniteteve në procesin e integrimit përmes transparencës, pjesëmarrjes dhe ndërtimit të besimit publik.

Analiza e Sherbimit

Bashkia ka ngritur dhe ruajtur strukturat e performancës në organizimin funksional si dhe komisionin e Integrimit Evropian pranë Këshillit Bashkiak, duke siguruar një kuadër institucional të qëndrueshëm për procesin e integrimit.

Në aspektin e projekteve, gjatë vitit 2024 janë bërë 6 aplikime në projekte të BE (nga 4 në vitin 2023), ndërkohë që numri i projekteve të fituara ka mbetur i njëjtë me 2. Ky bilanc tregon një rritje të përpjekjeve dhe angazhimit, me një sukses rate të qëndrueshëm në raport me aplikimet.

Nga ana tjetër, numri i marrëveshjeve ndërbashkiake ka rënë nga 2 në vitin 2023 në 0 në vitin 2024, ndërsa Plani Vendor i Migracionit dhe Diasporës ende mungon.

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Numri i marrëveshjeve ndërbashkiake të nënshkruara nga secila bashki	Numër	2.00	0.00	-2.00	↓	Përkeqësuar	●	-100%

Tregues	Ekzistenca dhe funksionimi i strukturave të performancës në bashki	Cilësore (Po/Jo)	1.00	1.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Tregues	Projekte të fituara kundrejt të aplikuara nga bashkimi evropian (periudha 2-vjeçare 2023-2024)	%	50.00	33.33	-16.67	↓	Përkeqësuar	●	-33%
Tregues	Planet e migracionit dhe diasporës	Cilësore (Po/Jo)					Mungon	●	
Tregues	Komisionet e integrimit evropian pranë këshillave bashkiakë	Cilësore (Po/Jo)	0.00	0.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	

A) Treguesit përmbledhës

C) Shtojcë: Të dhënat burim (Tbl_TeDhenat)

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Numri i marrëveshjeve ndërbashkiake të nënshkruara	2.00	0.00	Numër
Struktura e performancës e përfshirë në organizimin funksional të bashkisë	1.00	1.00	Cilësore (Po=1/Jo=Bosh).
Strukturat e performancës ngritur pranë drejtorisë së Integrimit Evropian sipas manualeve orientuese të AMVV-së	1.00	1.00	Cilësore (Po=0/Jo=Bosh).
Numri i projekteve të BE që bashkia ka aplikuar gjatë periudhës se raportimit	4.00	6.00	Numër
Numri i projekteve të BE të fituara gjatë periudhës se raportimit	2.00	2.00	Numër
Plani Vendor i Migracionit dhe Diasporës, i miratuar apo zbatuar gjatë periudhës së raportimit			Cilësore (Po=0/Jo=Bosh).
Komisionet e Integrimit Evropian pranë Këshillave Bashkiakë	0.00	0.00	Cilësore (Po=0/Jo=Bosh).

Sfida	Arritje	Objektiva
• Mungesë planesh për migracion/diasporë	• Dyfishim i marrëveshjeve bashkëpunuese • 100% sukses në projektet e BE-së	• Hartimi i planit për diasporën

MENAXHIMI FINANCIAR

Menaxhimi financiar është një funksion kyç për sigurimin e qëndrueshmërisë dhe eficiencës së qeverisjes vendore. Ai përfshin planifikimin, administrimin dhe raportimin e burimeve financiare të bashkisë, në përputhje me parimet e përgjegjshmërisë dhe transparencës. Në përmbushjen e këtij funksioni, bashkitë udhëhiqen nga kuadri ligjor për financat vendore, përfshirë Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe Ligjin Nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore". Kjo kategori ndahet në tre fusha të veçanta që mbulojnë ciklin financiar: të ardhurat, shpenzimet, dhe buxhetimi. Vlerësimi i këtyre fushave ndihmon në monitorimin e kapaciteteve financiare të bashkive dhe në analizimin e performancës së tyre në përdorimin dhe menaxhimin e burimeve publike.

Analiza e Sherbimit

Në vitin 2024, Bashkia Prrenjas ka ruajtur një **strukturë buxhetore të qëndrueshme**, me rritje të të ardhurave për frymë dhe përmirësim të përdorimit të fondeve, por me disa sfida në ekzekutimin e buxhetit dhe në peshën e investimeve ndaj totalit të shpenzimeve.

Të ardhurat dhe efikasiteti fiskal

Të ardhurat e veta për frymë janë rritur nga **3,452 lekë në 3,578 lekë**, me **+4%**, duke reflektuar përmirësim të lehtë në bazën e të ardhurave vendore dhe në nivelin e mbledhjes. Rritje të ngjashme ka shënuar edhe **të ardhurat nga taksa e pasurisë**, të cilat janë rritur nga **11.9% në 12.2%** të të ardhurave vendore, një sinjal pozitiv për forcimin e kapaciteteve tatimore vendore dhe regjistrin e pronës.

Megjithatë, **raporti i të ardhurave të veta ndaj transfertave** ka rënë nga **33.6% në 31.5%** dhe **raporti i të ardhurave të veta ndaj buxhetit** nga **25.2% në 24%**, duke treguar një **rritje të varësisë nga transfertat qendrore**. Kjo strukturë e varur financiare është tipike për bashki me bazë të kufizuar ekonomike, por thekson nevojën për nisma të reja në zgjerimin e të ardhurave të veta, sidomos përmes taksave mbi pasurinë, biznesin e vogël dhe tarifat e shërbimeve.

Përdorimi dhe ekzekutimi buxhetor

Buxheti i miratuar për frymë është rritur ndjeshëm nga **21,309 lekë në 24,381 lekë**, me **+14%**, duke reflektuar një ambicie më të madhe buxhetore dhe rritje të fondeve të alokuara për investime dhe shërbime publike.
Shkalla e përdorimit të të ardhurave është rritur nga **88.9% në 91.9%**, çka tregon **menaxhim më efektiv të të ardhurave të mbledhura** dhe përdorim më të mirë të fondeve në dispozicion. Megjithatë, **shkalla e ekzekutimit të buxhetit** ka rënë nga **72.4% në 66.7%**, një ulje me **-5.7 pikë përqindjeje**, që sinjalizon vonesa në zbatimin e projekteve apo kufizime në likuiditet gjatë vitit fiskal. Përmirësimi i planifikimit të fondeve dhe koordinimi më i ngushtë me njësitë shpenzuese do të ndihmonte në rritjen e ekzekutimit real.

Struktura e shpenzimeve

Pesha e shpenzimeve të personelit në buxhet është rritur nga **52.6% në 54.3%**, duke reflektuar ndikimin e **rritjes së pagave në administratën publike**???. Megjithatë, **pesha e shpenzimeve operacionale** është ulur lehtë (nga **23.2% në 22.5%**), ndërsa **pesha e investimeve** ka rënë nga **24.2% në 23.2%** megjithate ato jane rritur ne vlere absolute. **Investimet për frymë** janë ruajtur pothuajse të pandryshuara (3,732 → 3,767 lekë), duke treguar që niveli i investimeve është stabil në raport me popullsinë, por pa rritje domethënëse.

Detyrimet financiare

Një aspekt pozitiv është **eliminimi i plotë i detyrimeve të papaguara ndaj palëve të treta**, të cilat kanë kaluar nga **0.31% në 0%**, duke treguar **disiplinë financiare dhe përmirësim të ndjeshëm në menaxhimin e borxhit të brendshëm**.

Konkluzion

Në tërësi, Bashkia Prrenjas ka **rritur të ardhurat për frymë dhe përmirësuar përdorimin e fondeve**, duke ruajtur ekuilibrin financiar dhe stabilitetin buxhetor. Sfida mbetet **rritja e peshës së të ardhurave të veta**, **rritja e ekzekutimit buxhetor**, dhe **ulja graduale e kostos së personelit** për të liruar hapësirë buxhetore për investime dhe shërbime publike.

Sfida	Arritje	Objektiva

• Varësi e lartë nga transfertat • Të ardhura të veta të kufizuara	• Përmirësim i raportit të të ardhurave për frymë • Disiplinë në shpenzime	• Diversifikim i burimeve të të ardhurave • Përdorim më efikas i fondeve

TREGUESIT E PERFORMANCËS


A) Treguesit përmbledhës

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Të ardhurat e veta për frymë	leke/person	3452.48	3577.91	125.43	↑	Përmirësuar	●	4%
Tregues	Të ardhurat e veta përkundrejt transfertave	%	33.63	31.49	-2.15	↓	Përkeqësuar	●	-6%
Tregues	Raporti i të ardhurave të veta ndaj buxhetit	%	25.17	23.95	-1.22	↓	Përkeqësuar	●	-5%
Tregues	Shkalla e përdorimit të të ardhurave	%	88.94	91.93	2.99	↑	Përmirësuar	●	3%
Tregues	Të ardhurat nga taksa e pasurisë ne raport me të ardhurat vendore	%	11.92	12.20	0.28	↑	Përmirësuar	●	2%
Tregues	Buxheti i miratuar për frymë	leke/person	21308.92	24380.59	3071.67	↑	Përmirësuar	●	14%
Tregues	Shkalla e ekzekutimit të buxhetit	%	72.38	66.66	-5.72	↓	Përkeqësuar	●	-8%
Tregues	Investime për frymë	leke/person	3731.58	3767.20	35.62	↑	Përmirësuar	●	1%
Tregues	Pesha e investimeve në buxhet	%	24.19	23.18	-1.01	↓	Përkeqësuar	●	-4%
Tregues	Pesha e detyrimeve financiare të papaguara ndaj të tretëve	%	0.31	0.00	-0.31	↓	Përkeqësuar	●	-100%

Tregues	Pesha e personelit në buxhet	%	52.64	54.32	1.68	↑	Përmirësuar	●	3%
Tregues	Pesha e shpenzimeve operacionale në buxhet	%	23.16	22.50	-0.66	↓	Përkeqësuar	●	-3%

B) Shtojcë: Të dhënat burim (Tbl_TeDhenat)

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Të ardhurat e veta, fakt	94646.42	101279.93	Mijë Leke
Popullsia e përgjithshme e bashkisë	27414.00	28307.00	Numër
Transfertat gjithsej, fakt	281426.36	321672.24	Mijë Leke
Të ardhurat e përgjithshme, fakt	376072.78	422952.17	Mijë Leke
Totalit i shpenzimeve të bashkisë, fakt	422827.62	460067.02	Mijë Leke
Të ardhurat nga taksa e pasurisë, fakt	11281.73	12352.35	Mijë Leke
Shpenzime gjithsej, plan i rishikuar	584162.65	690141.27	Mijë Leke
Shpenzime kapitale, fakt	102297.51	106638.11	Mijë Leke
Detyrime të papaguara mbi 30 ditë	1320.67	0.00	Mijë Leke
Shpenzime personeli, fakt	222592.81	249919.36	Mijë Leke
Shpenzime operacionale, fakt	97937.30	103509.55	Mijë Leke



PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Ne kete sesion jane permbledhur arritjet kryesore, sfidat dhe objektivat qe bashkia do te konsideroje per vitin 2025, per fushat e mbuluara ne kete raport.

Fusha	Sfida	Arritje	Objektiva
Arsimi Parauniversitar	Shkalle e shume e ulet e mbulimit me sherbim te cerdhes dhe arsimit parashkollor •Mungesë e institucioneve parashkollore private	• Rritje e pjesëmarrjes në arsimin parashkollor • Staf mësimor i stabilizuar	• Përmirësim i kushteve infrastrukturore • Zbatimi i planeve vjetore për cilësinë mësimore
Menaxhimi i Mbetjeve	• Mungesë mbulimi në zonat rurale • Ndërgjegjësim i ulët për ndarjen në burim	• Shërbim i qëndrueshëm në qendër • Përdorim i rregullt i pikave të grumbullimit	• Zgjerim i mbulimit në fshatra • Fillimi i ndarjes në burim
Mbrojtja nga Zjarri	• Mbulim i pjesshëm i territorit pyjor me personel • Logjistikë e kufizuar	• Qendrueshmeri ne kapacitete (14 punonjës, 4 mjete) • Zbatim i planeve parandalues	• Rritje e stafit dhe pajisjeve • Trajnime të përvitshme për emergjencat
Ujitja dhe Kullimi	• Rrjete të amortizuara në disa zona bujqësore • Nevojë për financim të mirëmbajtjes	• Ruajtje e infrastrukturës ekzistuese • Funksionalitet i plotë i kanaleve kryesore	• Hartimi i planit të menaxhimit të rrjeteve • Rritja e sipërfaqes së ujitshme
Pyjet dhe Kullotat	• Mungesë burimesh njerëzore për zbatim në terren • Rrezik nga zjarret dhe dëmtimet	• Rritje e shkallës së planeve të mbarështimit (26% → 31%) • Strukturë funksionale e personelit	• Konsolidim i burimeve njerëzore • Zbatim i plotë i planeve të miratuara
Shërbimet Sociale	• Rënie e lehtë e përfituesve të ndihmës ekonomike	• Mbulim pothuaj i plotë i PAK	• Zgjerimi i shërbimeve komunitare

		• Përmirësim në mekanizmin e referimit	
👥 **Burimet Njerëzore**	• Nevojë për trajnime të vazhdueshme • Balancim mes stafit administrativ dhe shpenzues	• Rritje e stafit të trajnuar (9 → 20) • Stabilitet në strukturë	• Vijim i trajnimeve • Përmirësim i sistemit të vlerësimit të performancës
🕮 **Transparenca**	• Përdorim i kufizuar i kanaleve online • Mungesë ndërveprimi publik në konsultime	• Publikim i rregullt i akteve • Përmirësim i raportimit financiar	• Zhvillim i platformës online të transparencës • Rritje e pjesëmarrjes qytetare
⚖️ **Barazia Gjinore**	• Mungesë të dhënash të disagreguara gjinore • Niveli i ulët i grave në drejtim	• Rritje e pjesëmarrjes në trajnime • Rritje e grave në pozicione drejtuese (8 → 10)	• Hartimi dhe zbatimi i planit vendor për barazi gjinore
EU **Integrimi në BE**	• Mungesë planesh për migracion/diasporë	• Dyfishim i marrëveshjeve bashkëpunuese • 100% sukses në projektet e BE-së	• Hartimi i planit për diasporën
💶 **Menaxhimi Financiar**	• Varësi e lartë nga transfertat • Të ardhura të veta të kufizuara	• Përmirësim i raportit të të ardhurave për frymë • Disiplinë në shpenzime	• Diversifikim i burimeve të të ardhurave • Përdorim më efikas i fondeve